



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE

Nr. 1238/prot.
1

Tiranë më 12.9.2019

Lënda: Mendim mbi projektligjin "Për disa shtesa në ligjin nr.71/2016 "Për kontrollin kufitar".

MINISTRISË SË BRENDSHME

Tiranë

Në përgjigje të shkresës tuaj nr. 6837/1 Prot., datë 27.08.2019, me anë së cilës kërkohet mendim mbi projektligjin "Për disa shtesa në ligjin nr.71/2016 "Për kontrollin kufitar", në tërësi drafti vlerësohet i hartuar konform ligjit nr. 9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.

Duke iu referuar relacionit shpjegues, ky projektligj është përafuar pjesërisht me Direktivën 2004/82 CE e Këshillit të Evropian të datës 29 prill 2004 "Mbi detyrimin e transmetimit të të dhënave të pasagjerit (API)" si dhe me Direktivën 2016/681 të Parlamentit dhe Këshillit Evropian të datës 27.04.2016 "Mbi përdorimin e të dhënave të regjistrit të emrit të pasagjerit (PNR) me qëllim parandalimin, zbulimin, hetimin dhe ndjekjen e veprave penale me qëllime terroriste dhe krimeve të rënda".

Në këtë kuadër, Zyra e Komisionerit ka analizuar projektligjin në raport me dispozitat e akteve të lartpërmendura, si edhe me "Opinionin mbi mbrojtjen e të dhënave personale në përpunimin e të dhënave të pasagjerëve të transportit ajror (PNR)" të datës 19 gusht 2016, të Këshillit të Evropës.

Nga sa më sipër, konstatohet se në projektligjin e propozuar janë përfshirë të gjithë dispozitat e këtyre akteve, me përjashtim të pikave të mëposhtme për të cilat do të sugjerohet përfshirjen në projektligj, duke marrë parasysh ndikimin që mund të shkaktojë përpunimi i të dhënave të PNR-ve, tek privatësia dhe mbrojtja e të dhënave personale.

Në këtë kuadër vlerësojmë që, pas pikës 2, të nenit 19/1, të shtohet një pikë me këtë përmbajtje: "Transmetimi i të dhënave bëhet nëpërmjet metodës së "shtytjes", me përcaktim të qartë të periudhës fillestare të mbajtjes dhe masave të përshtatshme të sigurisë".

Ky sugjerim vjen me qëllim përafrimin me nenet 3 dhe 8 të Direktivës 2016/681, në të cilën parashikohet se, transmetimi i të dhënave nëpërmjet metodës së “shtytjes” konsiderohet se ofron një nivel më të lartë të mbrojtjes së të dhënave dhe duhet të jetë e detyrueshme për të gjithë transportuesit ajror. “Metoda e shtytjes” nënkupton metodën me të cilën transportuesit ajror transferojnë të dhënat PNR, të listuara në nenin 19/2, në bazën e të dhënave të pasagjerit që administrohet nga NIP. Masat e nevojshme për përdorimin e metodës së “shtytjes” për transportuesit ajror duhet të sigurohen nga NIP.

Referuar pikës 37, të preambulës së Direktivës 2016/681, sugjerojmë që pas pikës 2, të nenit 19/2, të shtohet një pikë me këtë përmbajtje: “Ndalohet mbledhja dhe përpunimi i të dhënave sensitive”. Autoritetet kompetente që përftojnë të dhënat PNR mund të përpunojnë të dhëna sensitive në rrethana të jashtëzakonshme dhe ngushtësisht të justifikuara. Opinioni i sipërpërmendur i KE-së, thekson ndalimin e përdorimit sistematik nga ana e autoriteteve kompetente të të dhënave sensitive, dhe përcaktimin e këtij parashikimi si parim.

Me qëllim përafrimin me nenin 13 të Direktivës 2016/681, sipas të cilit pasagjerët duhet të informohen në lidhje me mbledhjen e të dhënave PNR dhe të drejtat e tyre si, e drejta për informim, akses, korrigjim dhe fshirje të të dhënave, sugjerojmë që pas pikës 3, të nenit 19/9, të shtohet pika 4 me këtë përmbajtje: “Çdo pasagjer gëzon të drejtat e parashikuara në legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale, si e drejta për informim, akses, korrigjim dhe fshirje të të dhënave;

Gjithashtu sugjerojmë që në të gjithë tekstin e projektligjit, termi “Oficeri i Mbrojtjes së të Dhënave”, të zëvendësohet me termin e përdorur në legjislacionin shqiptar “Personi i ngarkuar për mbrojtjen e të dhënave”, duke e shoqëruar me akronimin (DPO), i cili i referohet termit në anglisht *Data Protection Officer*, të përdorur në nenin 5 të Direktivës 2016/681.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI
Besnik Dervishi

